VENDIM
Nr. 16, datë 3.4.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 3.4.2025, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 19 (K) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Kliton Spahiu

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mungesë.

Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2809, datë 2.7.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe gjykimi i çështjes me procedurë të përshpejtuar nga Gjykata Administrative e Apelit.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 42, pika 2, 44, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ),* nenet 27, 50, pika 4, 71, pika 1 dhe 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Kliton Spahiu *(kërkuesi)* që kërkoi pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGJ*) dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (*Gjykata e Apelit*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Durrës (*sot Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*) nga data 26.5.2010 deri në datën 2.6.2021, kur KLGJ-ja ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra, si dhe ndërprerjen e menjëhershme të pagës dhe të përfitimeve të tjera të magjistratit. Vendimi ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar nga kërkuesi.

2. Në vijim, kërkuesi ka ngritur padi në gjykatë, duke kërkuar detyrimin e KLGJ-së të njohë të drejtën për të përfituar pagën referuese në shumën 132,100 lekë, shtesën mbi pagën sipas kategorisë G2, me 98%, si dhe vjetërsinë e shërbimit në detyrë, nga data 1.1.2019 deri në datën 28.5.2021. Detyrimin e Gjykatës së Apelit Durrës që të paguajë për diferencën e pagës së papaguar

për periudhën 1.1.2019 deri në datën 29.5.2021, duke përfshirë edhe 10% të interesit ligjor mbi shumën e arrirë nga lindja e së drejtës e deri në momentin e shlyerjes së detyrimeve të papaguara. Detyrimin e të padituve për të paguar tarifën, shpenzimet e tjera gjyqësore dhe ato për kryerjen e ekzekutimit, si dhe dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, në zbatim të nenit 317, paragrafi i parë, shkronja "b", të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2075 (80-2022-2019), datë 7.7.2022, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe detyrimin e Gjykatës së Apelit Durrës t'i paguajë kërkuesit diferencat e pagës neto për periudhën nga data 1.1.2019 deri në datën 28.5.2021 në shumën 716,767 lekë, si dhe interesat bazuar në nenin 120 të Kodit të Punës në shumën 129,638 lekë, rrëzimin e padisë për palën e paditur, KLGJ-në, për mungesë legjitimi pasiv. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

4. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 31138-02761-86-2022, datë 15.9.2022. Deri në datën e paraqitjes së ankimit kushtetues individual, çështja e kërkuesit ka mbetur në pritje për t'u shqyrtuar.

5. Në datat 2.5.2023 dhe 2.4.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesa për përshpejtimin e gjykimit të çështjes së tij, për të cilat nuk ka marrë përgjigje. Në datën 11.6.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2809, datë 2.7.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se nuk vërehet ndonjë zvarritje e qëllimshme e çështjes nga gjyqtarja relatore, e cila i ka marrë të gjitha masat e nevojshme, duke përcaktuar kriteret transparente për marrjen e çështjeve që i janë ngarkuar asaj, sipas radhës së vjetërsisë.

7. Në datën 17.10.2024, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 23.10.2024. Kolegji i Gjykatës, në datën 27.12.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, të lidhur me *të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi ende nuk ka një datë planifikimi për shqyrtimin e çështjes së tij dhe as një vendimmarrje nga Gjykata Administrative e Apelit, pavarësisht se çështja ka për objekt marrëdhëniet e punës, të cilat shqyrtohen me përparësi nga gjykata. Për më tepër, vendimmarrja e Gjykatës së Lartë i ka cenuar edhe të drejtën për të përfituar shpërblim të drejtë dhe për të pasur një datë sa më të afërt në kohë për gjykimin e çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit.

9. ***Subjektet e interesuara, KLGJ-ja dhe Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë,*** nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të

pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor, për të cilin ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

12. Për sa i takon shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata vëren se kërkuesi, bazuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit në shqyrtimin e çështjes së tij dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit, kërkesë e cila është rrëzuar. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuesit për rivendosjen e së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual.

13. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual, Gjykata konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 2.7.2024 dhe kërkuesi i është drejtuar asaj në datën 17.10.2024. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sepse jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

14. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ky pretendim bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do ta analizojë atë në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

15. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi ende nuk ka një datë planifikimi për shqyrtimin e çështjes së tij dhe as një vendimmarrje nga Gjykata Administrative e Apelit. Gjykata e Lartë ka interpretuar gabim dispozitat procedurale, pasi çështja ka për objekt marrëdhëniet e punës, të cilat shqyrtohen me përparësi nga gjykata, për më tepër që, në rastin konkret, janë tejkaluar edhe afatet maksimale të përcaktuara nga ligji, duke u zgjatur më shumë se 2 vjet. Vendimmarrja e Gjykatës së Lartë i ka cenuar edhe të drejtën për të përfituar shpërblim të drejtë dhe për të pasur një datë sa më të afërt në kohë për gjykimin e çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit

16. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

17. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se mosmarrëveshja që është regjistruar për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit ka në objektin e saj detyrimin për kryerjen e pagesave të rrjedhura nga paga referuese dhe nga diferencat e pagave të papaguara për periudhën 1.1.2019–28.5.2021, për shkak të funksionit të tij si ish-magjistrat. Çështja është regjistruar fillimisht në gjykatën e shkallës së parë, e cila ka disponuar me vendimin e datës 7.7.2022, pranimin e pjesshëm të padisë. Në vijim, kërkuesi ka ushtruar ankim, i cili është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 15.9.2022. Në analizë të këtyre të dhënave rezulton se ndonëse kanë kaluar më shumë se 2 vjet e 6 muaj në Gjykatën Administrative të Apelit, ende nuk ka një datë për përfundimin e tij.

18. Duke iu referuar nenit 399/2, pika 1, shkronja "a", të KPC-së, Gjykata vë në dukje se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkuesit ka tejkaluar afatin 1-vjeçar të përcaktuar nga ligji si i arsyeshëm për përfundimin e gjykimit administrativ në apel. Në këto rrethana, për të vlerësuar nëse kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: i. sjelljen e kërkuesit; ii. kompleksitetin e çështjes; iii. sjelljen e

autoriteteve; iv. rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për sa i takon *sjelljes së kërkuesit*, merr rëndësi të analizohen rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata konstaton se kërkuesi ka shfaqur interes për ecurinë e shpejtë të gjykimit të çështjes, pasi i është drejtuar dy herë Gjykatës Administrative të Apelit, përkatësisht në datat 2.5.2023 dhe 2.4.2024, me kërkesa për përshpejtimin e gjykimit të çështjes së tij. Në kushtet kur ai nuk ka marrë asnjë përgjigje nga ajo gjykatë, në datën 11.6.2024 i është drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila e ka rrëzuar kërkesën dhe me tej ka paraqitur ankim kushtetues individual. Në këto rrethana, nuk rezulton që kërkuesi të jetë bërë shkak për vonesën në gjykim, por ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale.

21. Në lidhje me *kompleksitetin e çështjes,* Gjykata vëren se çështja ka në objektin e saj kërkimin për përfitimin e pagesave të rrjedhura nga paga referuese dhe nga diferencat e pagave të papaguara për periudhën 1.1.2019–28.5.2021, bazuar në legjislacionin për statusin e magjistratit, për shkak të funksionit të kërkuesit si gjyqtar. Palë të paditura në gjykim janë dy institucione shtetërore, KLGJ-ja dhe Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Në thelb, çështja lidhet me përcaktimin e fakteve bazuar në dokumente dhe në interpretimin e një numri të kufizuar normash ligjore pa pasur nevojë për marrjen e provave voluminoze dhe as për ndërthurje të shumta aktesh ligjore. Duke iu referuar këtyre aspekteve, Gjykata vlerëson se çështja e kërkuesit nuk paraqitet komplekse.

22. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, Gjykata vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga kërkuesi, i cili pas mbarimit të funksionit të tij si gjyqtar ka kërkuar përfitimin e pagesave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës. Ky lloj kërkimi përfshihet në grupin e çështjeve që shqyrtohen me përparësi nga gjykata e apelit, i klasifikuar si i tillë në kalendarin e miratuar nga KLGJ-ja *(shih shkronjën "gj", të pikës 3.1, të vendimit nr. 78, datë 30.5.2019, "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit", të ndryshuar [vendimi nr. 78/2019]*). Pavarësisht kësaj, Gjykata Administrative e Apelit ende nuk ka caktuar një datë për shqyrtimin e ankimit, ndonëse kanë kaluar më shumë se 2 vjet e 6 muaj nga regjistrimi i tij. Në gjykatën e apelit çështja e kërkuesit është rishortuar duke iu caktuar gjyqtarëve të ndryshëm, për shkak të riorganizimit të brendshëm. Përveç kalimit të akteve të çështjes nga njëri gjyqtar tek tjetri nuk rezulton të jenë kryer veprime të tjera, madje as kërkesat për përshpejtim të paraqitura nga kërkuesi nuk rezulton të jenë marrë në shqyrtim.

23. Edhe Gjykata e Lartë e ka refuzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave, duke arsyetuar se vonesa në gjykim lidhej me ngarkesën e lartë të çështjeve, numrin e pakët të gjyqtarëve dhe të stafit ndihmës që ushtronin detyrën në atë gjykatë. Sipas saj, mosveprimi i gjyqtarit relator nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive, si dhe nuk vërehet ndonjë zvarritje e qëllimshme e çështjes nga ai. Mirëpo këto arsye bëjnë që barra e vonesës së shkaktuar nga faktorë të pavarur nga kërkuesi të zhvendoset tek ai, duke mos u respektuar standardin kushtetues në këtë drejtim *(shih paragrafin 16 të vendimit)*. Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata çmon se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është në përputhje me Kushtetutën, ndaj duhet shfuqizuar.

24. Në lidhje me *atë çfarë rrezikon kërkuesi* në procesin gjyqësor, Gjykata ka vlerësuar se disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë " nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi, të tillë si ato që kërkojnë "kujdes të veçantë" ose "kujdes të jashtëzakonshëm" dhe që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme dhe pensionin. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkuesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti *(shih vendimet nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 21, datë 4.4.2024, nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, KLGJ-ja, në qasje me jurisprudencën evropiane, e cila ka çmuar se mosmarrëveshjet në fushën e punësimit për nga natyra e tyre kërkojnë vendimmarrje të përshpejtuar, i ka listuar ato si çështje prioritare për shqyrtim nga gjykata e apelit në vendimin e saj nr. 78/2019.

25. Ashtu siç u theksua (*shih paragrafin 17 të vendimit*), në themelin e procesit gjyqësor të vënë në lëvizje nga kërkuesi është pretendimi për përfitimet financiare të rrjedhura nga paga e magjistratit, pra në thelb është mosmarrëveshje në fushën e punësimit, e cila kërkon vendimmarrje të përshpejtuar. Për këto arsye, Gjykata çmon se çështja e kërkuesit për shkak të natyrës që ka, lidhet me interesa *vetjakë* dhe *jetësorë*, të tillë që duhet të shqyrtohen me prioritet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

26. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në kontekstin e situatës së përgjithshme të sistemit gjyqësor (burimet njerëzore, kushtet e punës dhe numri i lartë i çështjeve), kohëzgjatja e gjykimit administrativ (2 vjet e 6 muaj në apel) të çështjes së kërkuesit duket se nuk përbën *per se* shkak të mjaftueshëm për të konstatuar tejzgjatje të procedurave. Megjithatë, duke e ndërlidhur kohëzgjatjen e gjykimit të çështjes së tij me rrethanat e tjera, si mungesa e kompleksitetit të saj, mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit, përligjja e këtij mosveprimi nga Gjykata e Lartë, si dhe interesat vetjakë (përfitimi financiar i rrjedhur nga paga), Gjykata çmon se kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për rrjedhojë kërkesa e tij duhet të pranohet.

27. Gjithashtu, Gjykata, duke marrë në konsideratë veçoritë e çështjes së kërkuesit dhe mundësitë aktuale të Gjykatës Administrative të Apelit, çmon se bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, duhet urdhëruar detyrimi i kësaj gjykate ta shqyrtojë çështjen me përparësi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-2809, datë 2.7.2024, të Kolegji Administrativ të Gjykatës së Lartë.
3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm.
4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit ta shqyrtojë çështjen me përparësi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 3.4.2025.
Shpallur më 24.4.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Marjana Semini